Numër: 01/269
Datë: 17.05.2023

Këshilli Drejtues i Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve- ka shqyrtuar ankesën Nr.01/161, e datës 05.04.2023, e parashtruar nga institucioni Instituti për Aftësime Profesionale "KTC", me adresë: Arbëria 1, Lagja Ulpiana, Fushë Kosovë, Republika e Kosovës, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/132, i datës 31.03.2023, duke vepruar në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.05.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar** ankesa Nr.01/161, e datës 05.04.2023, e parashtruar nga institucioni Instituti për Aftësime Profesionale "KTC".

2. **Mbetet** në fuqi vendimi Nr.01/132, i datës 31.03.2023, i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit Instituti për Aftësime Profesionale KTC, për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipeve të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe raportet e ekipeve të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues

dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipet e ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, dokumenteve shtesë të dërguara nga ky institucion pas vizitës, si dhe komenteve të dërguara në draft raportet e validimit dhe akreditimit nga Instituti për Aftësime Profesionale "KTC", ekipet e ekspertëve në raportet përfundimtare të hartuar ka dhënë vlerësim pozitiv për kualifikimin **Instalues Elektrik,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 22 kredi të AAP me kohëzgjatje 2 vjeçare, dhe vlerësim negativ për kualifikimin **Muratorë dhe Punëtorë të Ngjashëm,** niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 25 kredi të AAP, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të vendimit Nr.01/132, i datës 31.03.2023.

Instituti për Aftësime Profesionale ka pranuar vendimin nr. 01/132 të datës 31.03.2023 Këshillit Drejtues të AKK-së, me datën 31.03.2023.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me 01/132 të datës 31.03.2023 të Këshillit Drejtues të AKK-së, ka atakuar pjesërisht dy pikat të këtij vendimi, më saktësisht pikën *"1.3 Instalues Elektrik, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 22 kredi të AAP me kohëzgjatje 2 vjeçare"*; dhe pikën *"2. Muratorë dhe Punëtorë të Ngjashëm, niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 25 kredi të AAP"*.

Institucioni Instituti për Aftësime Profesionale "KTC", me datë 05.04.2023, parashtron ankesën me numër protokolli Nr.01/161 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

Administrimi i provave: Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Vendimi Nr.01/132, i datës 31.03.2023, i Këshillit Drejtues të AKK-së; Ankesën me numër protokolli Nr.01/161, e datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në AKK; Email së bashku me materialet dërguar nga Instituti për Aftësime Profesionale KTC me datën 05.04.2023 tek zyrtarët e AKK; Emali i zyrtar i datës 14.04.2023, dërguar nga zyrtarja e AKK drejtuar ekipit të ekspertëve për kualifikimin Murator dhe punëtor të ngjashëm ku të bashkëlidhura kanë qenë Ankesa Nr.01/161, e datës 05.04.2023 dhe materialet te dërguara për kualifikimin murator dhe punëtorë të ngjashëm në Email zyrtar tek zyrtarët e AKK nga Instituti për Aftësime Profesionale KTC me datën 05.04.2023;

Email zyrtar i datës 26.04.2023 së bashku me shkresën/përgjigjen e ekipit të ekspertëve të kualifikimit murator dhe punëtor të ngjashëm, ku përgjigja nga ekipi është:

"Ne, anëtarët e Panelit Vlerësues kemi analizuar ankesën e Institucionit KTC ndaj vendimit tone për mos-validimin e kualifikimit dhe mos-akreditimin e Institucionit për ofrimin a kualifikimit "Murator dhe punëtorët e ngjashëm", Niveli 3 sipas KKK.

Ne vlerësimin e kemi bere në bazë të dokumenteve të dorëzuara me aplikim, të ri-dorëzimeve shtese si dhe hapësirës dhe pajisjeve se dedikuar për këtë profil nga Institucioni.

Në baze te dokumenteve te dorëzuara gjate periudhës së vlerësimit, në bazë të hapësirave të dedikuara për praktikë profesionale si dhe kushteve të mundësuara nga institucioni në punëtori, ne kemi dhënë mendim negativ në kërkesën e institucionit për validim dhe akreditim te kualifikimit "Murator dhe punëtorët e ngjashëm", Niveli 3 sipas KKK.

Ne, anëtaret e Panelit Vlerësues qëndrojmë mbrapa vendimit për vlerësimin që e kemi bërë".

Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Vendimi Nr.01/132, i datës 31.03.2023, i Këshillit Drejtues të AKK-së; Ankesën me numër protokolli Nr.01/161, e datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në AKK; Email së bashku me materialet dërguar nga Instituti për Aftësime Profesionale KTC me datën 05.04.2023 tek zyrtarët e AKK; Emali i zyrtar i datës 14.04.2023, dërguar nga zyrtarja e AKK drejtuar ekipit të ekspertëve për kualifikimin instalues elektrik, ku të bashkëlidhura kanë qenë ankesa Nr.01/161, e datës 05.04.2023 dhe materialet e dërguara për kualifikimin instalues elektrik në Email zyrtar tek zyrtarët e AKK nga Instituti për Aftësime Profesionale KTC me datën 05.04.2023; Email zyrtar i datës 25.04.2023 së bashku me shkresën/përgjigjen e ekipit të ekspertëve të kualifikimit instalues elektrik, ku përgjigja nga ekipi është:

"Në lidhje me ankesën me nr protokoli 161/01 të dates 05.04.2023 të Institutit për Aftësime Profesionale " KTC" – Fushë Kosovë, drejtuar Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve – Kosovë, duke marrë në konsideratë komentet e Institutit për Aftësime Profesionale KTC – Fushë Kosovë, në lidhje me rekomandimet e ekipit të ekspertëve, më konkretisht Pjesa 2: Rezultatet e përgjithshme dhe përfundimet, ku KTC kundërshton rekomandimin për validim dhe akreditim me kohëzgjatje dy vjeçare dhe me monitorim pas gjashtëmujorit të parë, ekipi i ekspertëve ka shqyrtuar materialet dhe ankesën, me ç'rast jep përgjigjen si në vijim:

1. *Ekipi i ekspertëve ka bërë vlerësimin e KTC dhe ka prezantuar rekomandimet për fushat në të cilat është e nevojshme që të bëhen përmirësime, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën që është bërë në institucion.*
2. *Në ankesën dhe dokumentet e prezantuara, KTC nuk ka ofruar dëshmi bindëse se ka përparuar në drejtim të plotësimit të rekomandimeve të prezantuar më parë nga ekipi i ekspertëve.*
3. *Duke kuptuar faktin që KTC ende nuk ka filluar me implementim të programit dhe është në fazën fillestare, ekipi i ekspertëve vlerëson se KTC ka kapacitete dhe përvojën e duhur për t'i plotësuar rekomandimet. Sidoqoftë, ekipi i ekspertëve vlerëson se, në këto rrethana është e nevojshme që të bëhet një monitorim dhe vlerësim pas një periudhe të arsyeshme kohore, me qëllim që të sigurohet se KTC ka ndërtuar një sistem funksional të cilësisë përgjatë gjithë institucionit, dhe të vërtetojë nëse rekomandimet e ekspertëve por edhe zotimet e KTC janë duke u implementuar.*

Para një situate te tillë ne qëndrojmë pranë raporteve përfundimtare për Vlerësim dhe Akreditim si dhe pranë komenteve shtese dhënë me date 25.01.2023 si përgjigje në "Komente Institucionale mbi Raportin vlerësues për akreditim" derguar nga Institutit për Aftësime Profesionale " KTC" – Fushë Kosovë. Andaj, i rekomadojme Këshilli Drejtues të Autoritetit Kombetar të Kualifikimeve qe të qendrojë pranë vendimit të dates 27.03.2023".

Këshilli Drejtues i AKK-së, pasi ka shqyrtuar të gjitha dokumentacioni e lëndës, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga institucioni Instituti për Aftësime Profesionale "KTC", për pikat 1.3 dhe 2 të vendimit Nr.01/132, i datës 31.03.2023 është e ***pabazuar, sepse:***

Këshilli Drejtues i AKK-së, shqyrtoi pretendimet ankimore të institucionit Instituti për Aftësime Profesionale "KTC", që pretendohet se: pikat 1.3 dhe 2 të vendimi nr. Nr.01/132, i datës 31.03.2023 mund të ndryshojnë nëse bëhet verifikimi i dokumenteve të bashkëlidhura me Email e datës 05.04.2023.

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në legjislacionin në fuqi si dhe në vlerësimin e ekspertëve vlerësues të AKK të dhënë pas parashtrimit të ankesës së institucionit Instituti për Aftësime Profesionale "KTC" vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit Drejtues të AKK-së nuk është i ligjshëm mund të parashtroj padi në Gjykatën Kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Instituti për Aftësime Profesionale "KTC", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar KD së AKK